



K O N T R A T E

PER THEMELIMIN E SHOQERISE ANONIME

“CLUB MUZIKOR” SHA”

NENI 1

Aksioneret

Aksioneret e shoqerise “CLUB MUZIKOR” SHA jane ;

1. Ioanis Dhudhullaqis, i biri i Pavllos, dtl. 28.04.1970, lindur e banues ne Antheon 17/A Selanik te Greqise, me leternjoftimi N-0400573.
2. Nikolas Papadhopollos, i biri i Jorgjios, dtl. 1967, lindur dhe banues ne Akiliu 7, Siqes Selanik te Greqise, me leternjoftimi Nr.M-34666;
3. Gjergji Shemko, i biri i Nasit, lindur me 15.08.1968, lindur dhe banues ne Bilisht , me leternjoftimi nr. 017863;
4. Arben Bylykbashi, i biri i Selamit, dtl. 1969, lindur ne Bilisht dhe banues ne Tirane, rruga "Reshit Collaku", pallatet Shallvare, shk.7, ap.99;

NENI 2

Emertimi

Emertimi i shoqerise do te jete “CLUB MUZIKOR” SHA.

NENI 3

Selia

Shoqeria e ka seline ne qytetin e Tiranes, rruga "Tasim Shehu", pall.1,
ap.8.

NENI 4
Kapitali

Kapitali themeltar i shoqerise do te jete 2.000.000 (dymilion) leke dhe i ndare si me poshte ;

1. Ioanis Dhudhullaqis zoteron 26 % te kapitalit themeltar.
2. Nikolas Papadhopollos zoteron 26 % te kapitalit themeltar.
3. Gjergji Shemko zoteron 24 % te kapitalit themeltar.
4. Arben Bylykbashi zoteron 24 % te kapitalit themeltar.

NENI 5

Objekti

Ne fushen e perhapjes se vlerave kulturore e artistike shqiptare si brenda dhe jashte vendit nepermjet transmetimit me radio private. Te organizoj, menazhoj me persona fizik e juridik shqiptar dhe te huaj ne te gjitha fushat e artit si shfaqje artistike, si filmike , koncertale, teatrale, reklama.

Shoqeria brenda caqeve te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi, do te kryeje cdo operacion tregtar e financiar qe lidhet drejtperdrejte ose terthorazi me objektin e saj.

Shoqeria mund te hape edhe veprimtari te reja, te krijoje sipermarrje te tjera ose te marre pjese ne sipermarrje te tjera, si brenda ashtu edhe jashte vendit, pa cenuar objektin kryesor te shoqerise



NENI 6
Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine per te nje periudhe te pakufizuar , duke filluar nga data e marrjes se vendimit per regjistrimin e saj ne Gjykate.

NENI 7
Struktura

Shoqeria do te kete organet e saj qe jane ;

1. Asambleja e Aksionereve
2. Keshilli Mbikqyres





3. Drejtoria (Drejtori i Pergjithshem)

Rregullat e funksionimit te tyre parashikohen ne Statutin e shqerise dhe pranohen nga aksioneret.

Kryetar i Keshillit Mbikqyres eshte zoti Gjergji Shemko.
Drejtor i pare i Pergjithshem eshte zoti Gjergji Shemko.

NENI 8 Kontrata

Hartimi i Kontrates behet ne 4 (kater) ekzemplare origjinale, ne gjuhen shqipe dhe me vlere te barabarte.

NENI 9 Zgjidhja e mosmarreshjeve

Organi i zgjidhjeve te mosmarreshjeve , kur ato nuk zgjidhen me mirekuptim do te jete Gjykata.

NENI 10 Hyrja ne fuqi

Kjo kontrate, qe nga aksioneret gjendet ne pajtim me vullnetin e tyre do te hyje ne fuqi sot ne ditën e nenshkrimt te saj me _____ 1998.

AKSIONERET THEMELUES

IOANIS DHUDHULLAQIS NIKOLAS PAPADHOPULLOS
Ioanis Dhudhullaqis Nikolas Papadhopoulos

GJERGJI SHEMKO

ARBEN BYLYKBASHI

Gjergji Shemko

Arben Bylykbashi



STATUTI

I SHOQERISE ANONIME "CLUB MUZIKOR" SHA

Shoqeria anonime pa oferte publike
Kapitali themeltar 2 (dy) milion leke
Selia : rruga "Tasim Shehu",pall.1,ap.8, Tirane

Ne mbeshtetje te ligjit nr. 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" te nenshkruarit aksionere ;

1. Ioanis Dhudhullaqis, i biri i Pavllos, dtl. 28.04.1970, lindur e banues ne Antheon 17/A Selanik te Greqise, me leternjoftimi N-0400573.
2. Nikolas Papadhopollos, i biri i Jorgjios, dtl. 1967, lindur dhe banues ne Akiliu 7, Siqes Selanik te Greqise, me leternjoftimi Nr.M-34666;
3. Gjergji Shemko, i biri i Nasit, lindur me 15.08.1968, lindur dhe banues ne Bilisht , me leternjoftimi nr. 017863;
4. Arben Bylykbashi, i biri i Selamit, dtl. 1969, lindur ne Bilisht dhe banues ne Tirane, rruga "Reshit Collaku", pallatet Shallvare, shk.7, ap.99;

kane hartuar Statutin qe vijon te shoqerise Anonime pa oferte publike e emertuar "CLUB MUZIKOR" SHA si me poshte ;

Neni 1 : Forma.

Midis personave pronare te aksioneve te krijuara sic tregohen me poshte dhe te atyre qe mund te behen me pas pronare te aksioneve, eshte krijuar nje shoqeri anonime qe rregullohet nga ligjet ne fuqi dhe nga ky statut.

Neni 2 ; Objekti i veprimtarise

Shoqëria ka kete objekt :

- Ne fushen e perhapjes se vlerave kulturore e artistike shqiptare si brenda dhe jashte vendit nepermjet transmetimit me radio private. Te organizoj, menazhoj me persona fizik e juridik shqiptar dhe te huaj ne te gjitha fushat e artit si shfaqje artistike, si filmike , koncertale, teatrale, reklama.

Shoqëria brenda caqeve te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi, do te kryeje cdo operacion tregtar e financiar qe lidhet drejtperdrejte ose terthorazi me objektin e saj.

Shoqëria mund te hape edhe veprimtari te reja, te krijojë siper marrje te tjera ose te marre pjese ne siper marrje te tjera, si brenda ashtu edhe jashte vendit, pa cenuar objektin kryesor te shoqërise.

Neni 3. Emertimi

Emertimi i shoqërise eshte "CLUB MUZIKOR" Ne te gjitha aktet dhe dokumentet qe dalin nga shoqëria emertimi i saj do te ndiqet menjehere nga inicialet "SH.A" dhe nga shpallja e kapitalit themeltar te saj.

Neni 4. Vendndodhja e selise

Selia e shoqërise eshte ne Tirane, rruga "Tasim Shehu", pall.1, shk.1, ap.8.


Selia mund te transferohet ne cdo vend tjeter te Tiranes ose kudo ne Territorin e Republikës se Shqiperise me nje vendim te thjeshte te Keshillit Mbikqyres, qe ratifikohet nga Asambleja e zakonshme me e afert e aksionereve.

Neni 5 : Kohezgjatja

Shoqëria e ushtron veprimtarine e saj pa afat te kufizuar.

Shkurtimi i kesaj kohezgjatjeje ne rastin e nje prishjeje te pershpejtuar te shoqërise behet me vendim te Asamblese se Pergjithshme te jashtezakonshme te aksionereve.




Neni 6 : Kontributet dhe kapitali themeltar

Ne momentin e themelimit te shoqerise jane sjelle si kontribut ne para nje shume prej 2 (dy) milion leke, qe i pergjigjet vleres nominale te aksioneve e qe perbejne kapitalin themeltar te shoqerise. Keto aksione jane nenshkruar dhe shlyer teresisht nga ;

Te kater personat firmoses te ketij statuti.

Shuma e derdhur nga aksioneret eshte depozituar ne nje llogari te hapur ne emer te shoqerise tek _____ dhe derdhjet e nenshkruesve jane vertetuar nga nje certifikate e hartuar ne pjatim me ligjin dhe e nenshkruar nga kjo Banke.

Kapitali themeltar i shoqerise ne ditën e themelimit te saj, eshte 2 (dy) milion leke. Ky kapital eshte i ndare ne 2000 (dymije) aksione, secili me nje vlere nominale 1000 (njemije) leke.


pronesia e aksioneve eshte

1. Ioanis Dhudhullaqis zoteron 26 % te kapitalit themeltar.
2. Nikolas Papadhopollos zoteron 26 % te kapitalit themeltar.
3. Gjergji Shenko zoteron 24 % te kapitalit themeltar.
4. Arben Bylykbashi zoteron 24 % te kapitalit themeltar.

Neni 7 : Zmadhimi i kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar i shoqerise mund te zmadhohet sipas modaliteteve dhe menyrave te parashikuara ne nenet 150 deri 163 te ligjit " Per shoqerite tregtare"

Zmadhimi i kapitalit themeltar mund te kryhet vetem me vendim te Asamblese se jashtezakonshme te Aksionereve.



Aksioneret kane te drejten e perparemise per nenshkrimin e aksioneve te shlyeshme ne para qe emetohen per zmadhimin e kapitalit. Kjo e drejte eshte ne perpjestim me shumen e aksioneve te zoteruara nga secili aksioner perpara zmadhimit te kapitalit .

Neni 8 : Transferimi dhe shitja e aksioneve.

Aksionet e shoqerise jane te transferueshme.

Transferimi i pronesise se aksioneve nominative behet mbasi te jete marre miratimi me shkrim nga Keshilli Mbikqyres i shoqerise.

Perparesia ne transferimin e aksioneve iu takon aksionereve te tjere te shoqerise , sipas radhes se paraqitjes se ofertave, te cilat vleresohen nga Keshilli Mbikqyres.

Aksionet mund t'i transferohen cdo personi fizik e juridik, shqiptar ose i huja. keshilli Mbikqyres duhet t'i paraqitet nje kerkese ku percaktohet identiteti i personit qe i transferohet pronesia, numri i aksioneve qe parashikon transferimi i pronesise dhe cmimi i ofruar. Cmimi perfundimtar te shitjes se aksioneve e vendos Keshilli Mbikqyres, i cili mund te perdore edhe eksperte te autorizuar.

Por, ne qofte se Keshilli Mbikqyres ka refuzuar shitjen e aksioneve nje vleresi jo aksioner, brenda tete diteve nga data e njoftimit te refuzimit shitesi duhet te njoftoje shoqerise ne se ka hequr dore apo jo nga projekti i shitjes se aksioneve. Ne rast se shitesi nuk ka hequr dore, atehere Keshilli Mbikqyres duhet te behe qe aksionet te blihen nga nje ose disa persona te zgjedhur prej tij.

Neni 9 : Te drejttat dhe detyrat e lidhura me aksionet

Cdo aksion i jep zoteruesit te tij te drejten e marrjes te nje pjese nga fitimet e shoqerise ne perpjesetim me kuoten pjese te kapitalit qe ai perfaqeson.

Pronesia e nje aksione permban te drejten e plote te aderimit ne Statutin e shoqerise dhe ne vendimet e Asamblese.

Pervec ketyre, aksioni i jep zoteruesit te tij te drejten e votes dhe te perfaqesimit ne Asamblene e pergjithshme ne kushtet e parashikuara nga ligji ose te caktuara ne kete Statut.

Aksioneret jane pergjegjes materialisht deri ne kufirin e vleres nominale te aksioneve qe zoterojne.

Te drejtat dhe detyrimet e lidhura me aksionet e ndjekin ate ne cfaredo forme qe transferohet nga njera dore ne tjetren.

Neni 10 : E drejta e personit juridik dhe dokumentacioni.

Shoqeria "CLUB MUZIKOR" SHA fiton te drejten e personit juridik qe nga dita e regjistrimit ne Regjistrin Tregtar te Gjykates se Rrethit Tirane.

Shoqeria e zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikkuara ne dokumentet per krijimin e saj, Statutin dhe Kontraten per themelim.

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Neni 11: Organet.

Organet drejtuese dhe administruese te shoqerise jane :

- Asambleja e aksionereve, e zakonshme dhe e jashtezakonshme
- Keshilli Mbikqyres
- Drejtoria (Drejtori i Pergjithshem)
- Keshilli Operativ e Teknik

Shoqeria mund te krijojte ne kushtet e parashikuara nga ligji e te percaktuara ne kete Statut edhe Departamente, Dege (ose filiale) dhe Perfaqesi te saj.

Neni 12: Rregulla te perbashketa per mbledhjen e Asamblese.

a) Natyra e Asamblese dhe karakteri i detyrueshem i vendimeve.
Asamblete e pergjithshme te aksionereve cilesohen te zakonshme ose te

jashtezakonshme sipas natyres se vendimeve per te cilet ato jane thirrur qe te marrin. Çdo Asamble perfaqeson teresine e aksionereve me te drejte vote. Vendimet e Asamblese se Pergjithshme detyrojne te gjithë aksioneret, pavaresisht ne votojne kunder apo mungojne.

b) Thirrja dhe vendi i mbledhjes se Asamblese.

Asamblete e Pergjithshme te aksionereve thirren nga Kryetari i Keshillit Mbikqyres, nga jo me pak se dy anetare te ketij Keshili ose nga Drejtori i Pergjithshem.

Asamblete e Pergjithshme mblidhen ne seline e shoqerise ose ne çdo vend tjeter te treguar ne thirrjen qe i dergohet çdo aksioneri 15 dite perpara mbledhjes e qe permban rendin e dites.

c) Pjesemarrja e perfaqesimi ne Asamble.

Çdo aksioner ka te drejte te asistojë ne mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme dhe te marre pjese ne vendimet e saj, personalisht ose nepermjet nje perfaqesuesi te pajisur me mandat te posacem e ne kushtet e parashikuara nga ligji.

ç) Drejtimi i mbledhjes dhe procesverbalet

Mbledhjet e Asamblese drejtohen nga Kryetari i Keshillit Mbikqyres ose, ne mungese te tij, nga anetar i Keshillit i caktuar nga Kryetari. Drejtuesi i mbledhjes cakton edhe nje sekretar (qe mund te jete aksioner) per te mbajtur procesverbalin. Procesverbali pervec te tjerave permban edhe :

- daten dhe vendin e mbledhjes,
- numrin e aksionereve te pranishem dhe quorumin e arritur
- drejtuesin e mbledhjes
- rendin e dites
- dokumentat e raportet qe jane diskutuar,
- nje permblendhje te debateve,
- rezultatet e votimeve

Procesverbalet e mbledhjeve ruhen ne seline e shoqerise.

d) Quorumi dhe votimi

Ne Asamblete e Pergjithshme quorumi llogaritet per teresine e aksioneve qe perbejne kapitalin themeltar te shoqerise. E drejta e votes qe u perket aksioneve eshte perpjesetimore me kapitalin qe ato perfaqesojne. Çdo aksion i jep zoteruesit te drejten e nje vote. Votimi kryhet i vecante per cdo ceshtje apo vendim.

dh) Venia e dokumentave ne dispozicion te aksionereve.

Shoqeria mban dhe ve ne dispozicion te aksionereve, ne kushtet dhe afatet e parashikuara me ligj, dokumentat e llogarite vjetore qe shqyrton Asambleja.

Neni 13 : Asambleja e pergjithshme e zakonshme.


Asambleja e Pergjithshme e zakonshme mblidhet te pakten nje here ne vit, brenda 6 muajve qe pasojne mbylljen e vitit financiar. Ajo merr vendime te vlefshme ne mbledhjen e pare vetem kur aksionet e pranishem ose te perfaqesuar zoterojne jo me pak se 50% te aksioneve me te drejte vote.

Asambleja e zakonshme merr vendim me shumicen e votave qe zoterojne aksioneret e pranishem ose perfaqesuar. Vendimet e asamblese se zakonshme mund te jene edhe qarkullues. Per te realizuar kete lloj vendimi shperndaht projekti, mblidhen verejtjet dhe me pas firmoset vendimi perfundimtar, pa u mbledhur aksioneret fizikisht ne ndonje salle.

Mbledhjet e Asamblese mund te realizohen e quhen te vlefshme edhe nepermjet video-konferences. Ne kete rast mbledhja regjistrohet dhe shiriti magnetik autentik ruhet ne arkivin e shoqerise.

Asambleja e pergjithshme e zakonshme merr cdo vendim qe nuk sjell ndryshimin e statutit te shoqerise. Ajo ka keto kompetenca :

- miraton politiken e pergjithshme (strategjine afatgjate te zhvillimit te shoqerise)
- miraton plan-biznesin dhe planin financiar vjetor
- miraton, ndryshon ose hedh poshte llogarite vjetore qe jane shtruar per miratim,





vendos per shperndarjen e fitimit dhe destinimin e rezultatit ekonomik ne pajtim me ligjet dhe Statutin,

emeron dhe shkarkon Kryetarin dhe anetaret e Keshillit Mbikqyres (qe mund te quhet edhe Bord Drejtues), si dhe cakton shperblimet e parashikuara ne Statut per ta,

- miraton ose jo emertimet e anetareve te Keshillit Mbikqyres te bera nga vete ky keshill si emerime te perkohshme,
- shkarkon, me propozimin e Keshillit Mbikqyres, anetaret e Drejtorise (perfshire edhe Drejtorin e Pergjithshem),
- miraton pjesemarrjen ne sipermarrje te tjera, brenda ose jashte vendit,
- ratifikon ose jo ndryshimin e selise se shoqerise,
- emerone Ekspertin (ose Ekspertet Kontabel) te autorizuar dhe vendos per raportin e paraqitur prej tyre lidhur me marreveshjet qe i nenshtrohen autorizimit paraprak te Keshillit Mbikqyres.

Neni 14 : Asambleja e pergjithshme e jashtezakonshme.

Asambleja e pergjithshme e jashtezakonshme mblidhet me kerkesen e Kryetarit te Keshillit Mbikqyres, ose jo me pak se dy anetare te ketij Keshilli, ose te aksionereve qe zoterojne jo me pak se 1/4 e aksioneve te shoqerise.

Asambleja e jashtezakonshme mund te marre vendime te vlefshme ne mbledhjen e pare kur aksioneret e pranishem ne mbledhje zoterojne jo me pak se 3/4 e aksioneve me te drejte vote; kurse ne mbledhjen e dyte ky quorum eshte jo me pak se 1/2 e aksioneve me te drejte vote.

Vendimet e Asamblese se Pergjithshme merren me shumicen prej 3/4 te votave qe u perkasin aksionereve te pranishem.

Asambleja e jashtezakonshme ka keto kompetenca :

- te ndryshoje Statutin e Shoqerise,
- te vendose zmdhimin ose zvogelimin e kapitalit ne baze te procedurave te parashikuara ne ligj dhe raportit te paraqitur nga Keshilli Mbikqyres,
- te vendose per prishjen (ose shperndarjen) e shoqerise ne rast te humbjeve te konstatuara, sipas kushteve dhe procedurave te parashikuara ne ligj,

- te heqe te drejten e perparise se nenshkrimet te aksioneve, ne qofte se e cmon te arsyeshme ne rastin e zmadhimit te kapitalit,
- te ndryshoje kompetencat e Keshillit Mbikqyres dhe te Drejtorise (Drejtorit te Pergjithshem),

Mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme te jashtezakonshme verbalizohen dhe materialet ruhen ne arkivin e shoqerise.

Neni 15 : Keshilli Mbikqyres

Keshilli Mbikqyres zgjidhet nga Asambleja e zakonshme e shoqerise ne cdo 3 vjet. Ai perbehet nga pese anetare, njeri prej te cileve eshte Kryetar. Te gjithe anetaret e Keshillit Mbikqyres jane aksionere te shoqerise (ose duhet te behen te tille brenda nje viti nga dita e zgjedhjes).

Anetaret e Keshillit Mbikqyres jane te rizgjedhshem. Ata mund te revokohen nga Asambleja e pergjithshme e zakonshme vetem per shkaqe te perligjura.


Anetaret e Keshillit Mbikqyres jane te rizgjedhshem. Ata mund te revokohen nga Asambleja e Pergjithshme e zakonshme vetem per shkaqe te perligjura.

Anetaret e Keshillit Mbikqyres jane persona fizike ose juridike, qe nuk duhet te jene te punesuar ne shoqeri. Ne rastin kur nje anetar i Keshillit Mbikqyres eshte nje person juridik, ai duhet te caktoje nje perfaqesues te perhershem.

Nese nje ose disa vende te anetareve te Keshillit Mbikqyres mbeten bosh per shkak vdekje, shkarkimi ose doreheqje, zevendesimi i tyre behet jo me vone se tre muaj. Anetari i emeruar ne zevendesim te nje anetari tjetër, perfundon mandatin e paraardhesit.

Mbledhjet e Keshillit Mbikqyres behen me thirrjen e Kryetarit sa here qe qe kerkon interesi i shoqerise dhe te pakten nje here ne tre muaj. Mbledhjet mbahen ne seline e shoqerise dhe rendi i dites caktohet nga Kryetari.

Cdo anetar i Keshillit Mbikqyres mund t'i jape mandat nje anetari tjerer per ta perfaqesuar ne nje mbledhje te Keshillit.



Shqyrtimet dhe vendimet e Keshillit Mbikqyres jane te vlefshme kur numri i anetareve te pranishem ne mbledhje eshte jo me pak se gjysma e anetareve ne funksion.

Vendimet merren me shumicen e votave te anetareve te pranishem dhe te perfaqesuar. Ne rast votash te barabarta ajo e Kryetarit eshte percaktuese. Ne rastin e zgjedhjes ose shkarkimit te drejtorit te Pergjithshem te shoqerise kerkohet edhe vota e Kryetarit te Keshillit Mbikqyres).

Shqyrtimet dhe vendimet e Keshillit Mbikqyres evidentohen me procesverbale, qe nenshkruhen nga drejtuesi i mbledhjes dhe ruhen ne arkivin e shoqerise.

Vendimet e Keshillit Mbikqyres mund te jene edhe qarkulluese. Per te realizuar kete lloj vendimi, shperndahet projekti, mblidhen verejtjet dhe me pas firmoset vendimi perfundimtar pa u mbledhur anetaret fizikisht ne ndonje salle.


Mbledhjet e Keshillit mund te realizohen dhe quhen te vlefshme edhe nepermjet video-konferences. Ne kete rast mbledhja regjistrohet dhe shiriti magnetik autentik ruhet ne arkiv.

Keshilli Mbikqyres ka vullen e vet.

Kryetari i keshillit Mbikqyres te shoqerise "CLUB MUZIKOR" SHA eshte z. Gjergji Shemko.

Keshilli Mbikqyres ka keto kompetenca :

- ushtron kontrollin e perhershem te drejtimit dhe administrimit te shoqerise nga ana e Administrates se saj,
- miraton strukturen organizative te shoqerise dhe ndryshimet e saj, kriteret e punesimit dhe te pagave, si dhe rregulloren e brendshme te shoqerise,
- autorizon dhenien e dorezaneve dhe garancive,
- autorizon kryerjen e investimeve tej atyre te parashikuara ne programin financiar vjetor,



- autorizon hapjen e veprimtarive ose degeve te reja, shkrirjen, bashkimin ose mbylljen (teresisht a pjeserisht) te veprimtarive dhe degeve te shoqerise,
- autorizon pjesemarrjen ne shoqeri te tjera ;
- autorizon shitjen dhe shkembimin e pasurive qe perbejne aktive te qendrueshem te shoqerise ;
- autorizon shitjen dhe shkembimin e pasurive qe perbejne aktive te qendrueshem te shoqerise,
- autorizon negocimin, perfundimin apo ndryshimin e co kontrateje me afat ose per nje shume mbi dymilion leke ose ekuivalente ne valute (kufiri i kesaj shume caktohet per cdo vit),
- kryhen te gjitha verifikimet qe cmon te nevojshme dhe ka te drejte te kerkoje te njihet me dokumentet e duhura per permbushjen e detyrave te tij (kurse ne cdo tre mujor nje raport te paraqitur nga Drejtori i pergjithshem),
- miraton bilancin vjetor e ia paraqet Asamblese se zakonshme,
- miraton transferimin e aksioneve
- miraton praktikat e marketingut,
- miraton strukturen e tarifave baze te sherbimeve,
- therret dhe drejton mbledhjet e Asamblese,
- disponon per transferimin e selise se shoqerise,
- zgjedh Drejtorin e Pergjithshem (edhe drejtore te tjere) me votat e te pakten tre anetareve te Keshillit Mbikqyres, nje nga te cilet duhet te jete Kryetari i Keshillit ;

Neni 16 : Drejtoria

Drejtoria eshte organ ekzekutiv i shoqerise. Ne periudhen fillestare te veprimtarise se shoqerise "CLUB MUZIKOR" SHA detyrat e Drejtorise i kryen vetem nje person i emeruar Drejtor i Pergjithshem.

Drejtori i Pergjithshem (sikurse edhe drejtoret) emerohet per nje periudhe tre vjecare. Ai mund te shkarkohet para afatit per paaftesi profesionale, ose per shkak te gjendjes shendetesore te semure qe e ben te paaftte per plotesimin e detyres, ose per gabime te renda ne drejtimin e shoqerise.



Drejtori i Pergjithshem (sikurse edhe drejtoret) nuk mund te bejne pjese ne Keshillin Mbikqyres te shoqerise , por mund te jene aksionere ne te .

Menyra dhe masa e shperblimit te Drejtorit te Pergjithshem (dhe e drejtoreve ne te ardhmen) caktohet nga Keshilli Mbikqyres qysh ne aktin e emerimit.

Drejtori i Pergjithshem eshte pergjegjes per drejtimin dhe mirefunksionimin e shoqerise, si dhe per administrimin e pasurise se saj. Ai zbaton metodat dhe menytrat qe i cmon me te mira e me te pershtatshme per te realizuar detyrat e percaktuara nga Asambleja e Keshillit Mbikqyres.

Drejtori i Pergjithshem ka kompetenca te plota per te vepruar ne cdo rrethana ne emer te shoqerise , por kufizohet nga ato kompetenca qe ligji dhe ky Statut ua ka dhene shprehimisht Keshillit Mbikqyres dhe Asamblese se Aksionereve.

Drejtori i Pergjithshem i ushtron kompetencat e veta brenda objektit te shoqerise. Ne marredhenie me te tretet ai perfaqeson shoqerine, e cila merr persiper detyrimet nga aktet apo veprimet e perfunduara prej tij, kur keto jane te lidhura me objektin e shoqerise.

Te gjitha aktet dhe vendimet e Drejtorit te Pergjithshem firmosen, vulosen, protokollohen dhe ruhen ne arkiv.

Drejtori i Pergjithshem perdor vulen e shoqerise.

Ne fillim te veprimtarise se saj Drejtori i Pergjithshem i shoqerise "CLUB MUZIKOR" SHA eshte z. Gjergji Shemko.

Drejtori i Pergjithshem ka keto kompetenca :

- propozon vendime e akte te tjera per Keshillin Mbikqyres ose Asamblene e Aksionereve,
- kerkon thirrjen e Asamblese se Pergjithshme kur Keshilli Mbikqyres i refuzon autorizimin per nje operacion qe i lypset ky autorizim (sic jane operacionet qe parashikohen ne nenin 15 te ketij Statuti),

- emeron dhe shkarkon Shefat e Sektoreve dhe personelin tjeter administrativ, si dhe percakton menyren dhe pagat e tyre,
- miraton kontraten tip te punes dhe kontraten tip me abonentet,
- merr vendime per marredheniet financiare brenda shoqerise dhe me personat e trete jashte saj,
- merr vendime per zgjidhjet teknike te rrjetit,
- autorizon shperblimet e vecanta e honoraret per punonjes te vecante te shoqerise ose persona te tjere jashte saj.

Ne cdo rast Drejtori i Pergjithshem eshte i detyruar qe, per veprimtarine e tij ne pergjithesi ose per probleme te vecanta, te raportoje ne Asamblene e aksionereve (kur kete e kerkojne aksionere qe zoterojne jo me pak se 1/5 e kapitalit te shoqerise) dhe ne Keshillin Mbikqyres (kur kete e kerkojne Kryetari ose jo me pak se tre anetare te ketij Keshilli).

Drejtori i Pergjithshem ndihmohet ne aktivitetin e tij nga Keshilli Operativ e Teknik.

Drejtori i Pergjithshem ka te drejte te delegoje pjese te kompetencave te tij.

Neni 17 : Keshilli Operativ - Teknik

Keshilli Operativ Teknik eshte organ konsultativ i Drejtorit te Pergjithshem, ne te cilin marrin pjese ky i fundit me cilesine e Kryetarit dhe keshilltaret e Shefat e Sektoreve, me cilesine e anetareve.

Keshilli Operativ - Teknik mblidhet me kerkesen e Drejtorit te Pergjithshem ose te jo me pak se dy anetareve te tij.

Keshilli Operativ - Teknik nuk merr vendime, por i ben Drejtorit te Pergjithshem ne lidhje me problemet e drejtimit dhe administrimit te shoqerise, koordinimit te punes midis sektoreve, si dhe problemet e shfrytezimit te rrjetit ose te zgjerimit te tij.

Propozimet e ketij Keshilli miratohen me shumice votash.

Per anetaret e Keshillit Operativ - Teknik nuk parashikohet shperblim i vecante, pervec rasteve kur ata ngarkohen per te kryer studime e per te hartuar projekte qe tejkalojne detyrat e punes normale te tyre.

Neni 18 : Marreveshjet e ndaluara dhe marreveshjet qe kerkojne autorizim.

Anetaret e Keshillit Mbikqyres dhe te Drejtorise (Drejtori i Pergjithshem) u ndalohet te kontraktojne qe te marrin hua nga shoqeria, t'u akordohet llogari rrjedhese ose ne nje forme tjeter, dhe te bejne shoqerine dorezenese apo garante per detyrimet e tyre ndaj te treteve.

Cdo marreveshje ndermjet shoqerise dhe njerit nga anetaret e Keshillit Mbikqyres ose Drejtorise (Drejtorit te Pergjithshem), qe lidhet drejtperdrejte ose terthorazi (me ndermjetsim), duhet te autorizohet paraprakisht nga Keshilli Mbikqyres (nga Kryetari, apo jo me pak se tre anetare te ketij Keshilli).

KONTABILITETI DHE FINANCAT E SHQERISE

Neni 19 : Aftesia paguese.

Shoqeria "CLUB MUZIKOR" SHA krijon marzhin e aftesise paguese te mjaftueshme per veprimtarine e saj, duke perfshire te gjitha vleren e pasurive, si kapitalin themeltar, rezervat, fitimet e mbartura etj.

Neni 20 : Ushtrimi financiar

Ushtrimi financiar fillon ne 1 janar dhe mbaron ne 31 dhjetor te cdo viti. Perjashtimisht ushtrimi i pare financiar perfshin kohen dhe data e regjistrimit ne Regjistrin Tregtar deri ne 31 dhjetor.

Neni 21 : Bilanci vjetor

Shoqeria do te mbaje kontabilitet te rregullt te pasurise dhe veprimtarise se saj, ne pajtim me kerkesat e ligjit. Per ndjekjen e gjendjes financiare Drejtori i Pergjithshem, sipas struktures dhe permbajtjes te percaktuara ne planin



kontabel, pergatit raportin mbi gjendjen financiare cdo tremujor si dhe ate vjetor.

Ne mbylljen e cdo viti financiar hartohet inventari i pasurise dhe llogarite vjetore ne perputhje me dispozitat ligjore per kontabilitetin, si dhe raporti vjetor mbi gjendjen financiare te shoqerise gjate ushtrimit te kaluar, ku parashikohen dhe ndryshime per te ardhmen e veprimtarite e tjera te shoqerise.

Keto dokumenta i jepen ekspertit kontabel nje muaj perpara mbledhjes se Asamblese se aksionereve, i cili ben komentat e veta ne nje raport te vecante.

Neni 22 : Miratimi i bilancit.

Raporti per gjendjen financiare te shoqerise, i detajuar per te gjitha operacionet dhe per gjendjen e administrimit te shoqerise paraqitet nga Drejtori i Pergjithshem ne fund te vitit financiar ne Keshillin Mbikqyres, i cili e miraton dhe ia paraqet Asamblese se zakonshme te aksionereve.

Neni 23 : Rezultati i ushtrimit financiar dhe rezervat.

Rezultati i ushtrimit financair percaktohet si difference ndermjet te ardhurave dhe shpenzimeve te ushtrimit, duke perfshire ne keto te fundit edhe amortizimet, provizionet dhe taksat.

Nga fitimet e ushtrimit te pakesuara kur eshte rasti me humbjet e meparshme, hiqet te pakten 5 % per te krijuar rezerven e domosdoshme. Heqja nga fitimet per rezerven e domosdoshme pushon se qeni e detyrueshme kur kjo rezerve arrin 15 % te kapitalit themeltar.

Asambleja e zakonshme ne rast nevojje mund te formoje dhe fonde te tjera. Shuma e fitimeve te mbetura pas krijimit te rezervave si me siper, perfaqeson dividendin.

Aksioneret kane te drejte te marrin pjesen e fitimit te destinuar per ndarje nga Asambleja e zakonshme, proporcionalisht me pjesemarrjen e tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Neni 24 : Pergjegjesite ndaj Shtetit.

Shoqeria ka llogarite e saj bankare dhe pergjigjet me fondet e saj per taksat dhe detyrimet e tjera ndaj Shtetit.

Neni 25 : Ekspertet kontabel.

Kontrolli financiar ushtrohet nga nje ose disa eksperte te autorizuar , te licensuar konform legjislacionit shqiptar, te cilet emerohen nga Asambleja e zakonshme dhe kryejne misionin e tyre ne pajtim me ligjin.

Ekspertet kontabel jane te autorizuar qe ne cdo kohe te vitit se bashku ose vec e vec, te bejne te gjitha verifikimet e kontrollet qe gjykojne te domosdoshme dhe mund te shfrytezojne te gjitha dokumentacionin e vleresuar si te dobishem ne ushrimin e funksionit te tyre, ne vecanti, kontratat, librat e llogarise, dokumentat kontabel dhe regjistrat e procesverbaleve.

Detyrat dhe te drejtat e eksperteve kontabel te pavarur te shoqerise jane ato te parashikuara nga ligji "Per shoqerite tregtare".

Ekspertet kontabel informojne Keshillin Mbikqyres dhe Drejtorin e Pergjithshem per :

- kontrollet , verifikimet dhe sondazhet qe kane kryer,
- pjeset e bilancit dhe te dokumentave te tjera te kontabilitetit ku ata kane verejtje,
- parregullsitet dhe pasaktesitet ~~qe kane zbuluar~~.

Ekspertet kontabel thirren ne mbledhjen e Keshillit Mbikqyres kur mbyllet llogarite e vitit financiar si dhe ne mbledhjen e Asamblese. Ata jane pergjegjes si ndaj shoqerise, ashtu edhe ndaj te treteve per pasojat qe rrjedhin per fajin e nenvleftesimit te tyre gjate ushrimit te funksioneve qe kane.

Honoraret e eksperteve i ngarkohen shoqerise. Keshilli Mbikqyres, me rastin e miratimit te eksperteve, miraton dhe masen e shperblimit te tyre.

Marredheniet e eksperteve kontabel me shoqerine percaktohen ne nje kontrate midis tyre dhe Drejtorit te Pergjithshem.

Neni 26 Likuidimi

Shpërndarja e shoqërisë "CLUB MUZIKOR" SHA mund të bëhet në çdo kohë, kur për shkak të ndryshme nuk mund të vazhdojë aktivitetin e saj. Në këtë rast ajo vihet në likuidim.

Likuidimi bëhet në pajtim me dispozitat e ligjit "Për shoqëritë tregtare" e të ligjit "Për procedurën e falimentimit".

Asambleja e jashtëzakonshme e aksionerëve cakton likuidatorët duke përcaktuar edhe kompetencat që ata kanë.

RREGULLIMI I SHOQËRISE

Neni 27 : Ndryshimet e kapitalit themeltar.



Ndryshimet e kapitalit themeltar, zmadhimi ose zvogëlimi i tij, si dhe menyrat e realizimit të tyre, do të përcaktohen konform dispozitave të ligjit nr. 7638, datë 19.11.1993 "Për shoqëritë tregtare" dhe të akteve të tjera ligjore në fuqi.

Neni 28 : Transformimi në shoqëri me oferte publike.

Shoqëria "CLUB MUZIKOR" SHA pa oferte publike mund të transformohet në shoqëri anonime me oferte publike. Vendimi për këtë transformim merret nga Asambleja e jashtëzakonshme e aksionerëve.

Neni 29 : E drejta e komunikimit dhe informimit.

Cdo aksioner ka të drejtën e komunikimit e të informimit të vazhdueshëm. Para mbledhjes së çdo Asambleje ose konsulte, cdo aksioner ka të drejtën e njohjes së dokumentacionit e të informacioneve të tjera që lidhen me problemin që do të diskutohen ose konsultohen. Këto duhet t'i vihen në dispozicion aksionerit në kushtet e përcaktuara në dispozitat ligjore dhe rregulloret në fuqi.



Neni 30 : Fshehtesia e informacionit.

Te gjithë aksioneret, anetaret e Keshillit Mbikqyres, drejtoret (Drejtori i Pergjithshem) dhe te punesuarit e tjere te shoqerise jane te detyruar te ruajne fshehtesine e cdo informacioni ao te dhene ne lidhje direkte ose indirekte me shoqerine per te cilat ata vihen ne dijeni gjate ushtrimit te aktivitetit te tyre ose ne menyre te terthorte. Ata duhet te marrin te gjitha masat e nevojshme dhe te zbatojne procedurat e percaktuara per te penguar perhapjen ne cfaredo lloj forme te informacionit.

Te gjithë aksioneret, anetaret e Keshillit Mbikqyres, drejtoret (Drejtori i Pergjithshem) dhe te punesuarit e tjere pergjigjen per pasojat e demshme qe i shkaktohen shoqerise nga perhapja e paautorizuar e informacionit.

Neni 31: Marredheniet me punonjesit.

Marredheniet e shoqerise me punonjesit rregullohen sipas legjislacionit mbi marredheniet e Punes ne Republiken e Shqiperise.

Neni 32: Falimentimi, paaftesia ose vdekja e nje aksioneri.

Shoqeria nuk priset kur falimenton, vdes ose shfaq paaftesi fizike apo mendore njeri nga aksioneret.

Neni 33 : Vula dhe logoja.

Shoqeria "CLUB MUZIKOR" SHA ka vulen e vet, te rrumbullaket ne qender te te ciles vendoset logoja qe permban emrin e shoqerise dhe adresen e selise se saj.

Cdo dege (ose Filial) dhe perfaqesi ka gjithashtu vulen e vet me specifikimet perkatese dhe te ndryshme nga ajo e shoqerise.

Neni 34: Mosmarreshjet.

Per mosmarreshjet midis aksionereve, te punesuarve dhe personave te trete ne rast se zgjidhja nuk arrihet me mirekuptim (konsensus) ajo behet objekt i gjykates kompetente.

Neni 35 : Rastet e paparashikuara.

Rastet e paparashikuara ne kete Statut do te trajtohen sipas parashikimeve te ligjit nr.7638, date 19.11.1993 " Per shoqerite tregtare" dhe akteve te tjera ligjire ne fuqi.

Neni 36 : Gjuha, kopjet origjinale dhe nenshkrimi i statutit.

Ky statut eshte hartuar ne kater kopje, ne gjuhen shqipe dhe me vlere te barabarte.

Hartuesit e ketij Statuti e gjejne ne pajtim me vullnetin e tyre dhe e nenshkruajne rregullisht ne Tirane, soe me date _____ 1998.

AKSIONERET

Ioanis Dhudhullaqis

Ioanis Dhudhullaqis




Nikolas Papadhopollos

Nikolas Papadhopollos

Arben Bylykbashi

Arben Bylykbashi



Gjergji Shenko

Gjergji Shenko

